

Hapat e regjistrimit në Maratonën e Tiranës 2018:

Tirana 10K

Half Marathon

Metoda 1: Butoni EasyPay



Vizito www.tiranamarathon.com



Kliko Regjistrohu dhe zgjidh një nga kategoritë



Pasi keni klikuar kategorinë, plotësoni të gjitha të dhënat që ju kërkohen: Emër, Mbiemër, Numri personal i letërnjoftimit, Gjinia, Ditëlindja, Shteti, Adresa, Numri i telefonit dhe adresa personale e email-it.



Pasi të siguroheni që të dhënat janë të sakta, klikoni konfirmimet për statusin e shëndetit dhe termat e kushtet.



Më pas, klikoni butonin EasyPay:

a. EasyPay - klient ekzistues

i. Nëse jeni i regjistruar si klient EasyPay, mund të kryeni pagesën direkt duke u loguar me kredencialet tuaja të llogarisë EasyPay dhe duke marrë parasysh që të keni balance të mjaftueshme në llogari për kryerjen e pagesës.

ii. Vendosni emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin tuaj. Në rast se keni harruar fjalëkalimin, mund ta rivendosni direkt nga aplikacioni ose mund të kontaktoni EasyPay në një nga numrat e kontaktit apo në clientsupport@easypay.al.

iii. Pasi të jeni loguar, konfirmoni pagesën dhe në adresën tuaj të email-it do të vijë një konfirmim pagese si dhe bileta elektronike që ju mundëson hyrjen në Maratonë.

b. EasyPay - klient i ri

i. Nëse nuk keni një llogari aktive në EasyPay, mund të shkarkoni aplikacionin EasyPay falas dhe të plotësoni të dhënat që kërkohen në aplikacion. Siguroni të ngarkoni një foto të qartë të kartës suaj të identitetit ose pasaportës. Të dhënat tuaja do të verifikohen brenda 24 orësh dhe më pas ne do t'ju lajmërojmë sapo llogaria juaj do të aktivizohet.

ii. Sapo llogaria juaj të jetë aktivizuar, ju do të keni mundësinë të rimbushni llogarinë tuaj EasyPay me një nga 3 mënyrat e mëposhtme:

1. Me një kartë krediti ose debiti Visa dhe Mastercard
2. Me para në dorë (cash) tek pika EasyPay më e afërt: bit.ly/agjenteasypay
3. Direkt nga llogaria bankare (më shumë detaje në aplikacion)

iii. Kur të jeni siguruar që keni balance të mjaftueshme në llogari, atëherë vizitoni www.tiranamarathon.com dhe ndiqni hapat e mësipërm.



Tarifa e Pjesëmarrjes: 5 Euro (Tirana 10k), 10 Euro (Half Marathon)



Përfundimi i afatit të regjistrimit: E Martë, ora 00:00, data 02 Tetor 2018

Hapat e regjistrimit në Maratonën e Tiranës 2018:

Tirana 10K

Half Marathon

Metoda 2: VISA



Vizito www.tiranamarathon.com



Kliko Regjistrohu dhe zgjidh një nga kategoritë



Pasi keni klikuar kategorinë, plotësoni të gjitha të dhënat që ju kërkohen: Emër, Mbiemër, Numri personal i letërnjoftimit, Gjinia, Ditëlindja, Shteti, Adresa, Numri i telefonit dhe adresa personale e email-it.



Pasi të siguroheni që të dhënat janë të sakta, klikoni konfirmimet për statusin e shëndetit dhe termat e kushtet.



Më pas, klikoni butonin Visa:

i. Nëse keni një kartë krediti apo debiti Visa, mund ta përdorni për të kryer pagesën e Maratonës duke ndjekur hapat si më poshtë:

1. Klikoni 'Cardholder same as participant' nëse karta që po përdorni është e juaja dhe 'Cardholder is not the participant' nëse karta që po përdorni është e dikujt tjetër.

a. Nëse karta nuk është e juaja, atëherë plotësoni të dhënat që kërkohen për kartëmbajtësin:
Emër, Mbiemër, Email, Numri I telefonit dhe Adresa

2. Klikoni Continue (Vazhdo)

3. Vijoni me plotësimin e të dhënave të kartës suaj. Vendosni emër dhe mbiemër të kartëmbajtësit (Name on Card); Numrin e kartës (zakonisht është një numër 12-shifror); Datën e skadencës dhe kodin civil CC2* (3 shifrat e fundit të shënuar në pjesën e prapme të kartës suaj)

4. Klikoni Proceed with Payment (Procedo me Pagesën)

5. Në varësi të bankës suaj, do t'ju kërkohet sërish një hap i fundit verifikimi që mund të përfshijë fjalëkalimin që keni vendosur ose numrin e klientit të bankës. Nëse nuk I mbani mend, duhet të kontaktoni bankën që ka lëshuar kartën për më tej.

6. Sapo të keni përfunduar të gjithat hapat e mësipërm, në adresën tuaj të email-it do të vijë një konfirmim pageze si dhe bileta elektronike që ju mundëson hyrjen në Maratonë.



Tarifa e Pjesëmarrjes: 5 Euro (Tirana 10k), 10 Euro (Half Marathon)



Përfundimi i afatit të regjistrimit: E Martë, ora 00:00, data 02 Tetor 2018

Hapat e regjistrimit në Maratonën e Tiranës 2018:

We Too

 Hapat e regjistrimit për kategorinë We Too janë të njëjtë me ato të kategorive Half Marathon dhe Tirana 10k përveç pjesës së pagesës duke qenë se ofrohet falas. Gjithashtu personat duhet të plotësojnë numrin e librezës së identitetit për përfituesit e statusit të individit paraplegjik.

 Tarifa e Pjesëmarrjes: FALAS

 Përfundimi i afatit të regjistrimit: E Martë, ora 00:00, data 02 Tetor 2018

KUJDES!

Pika për t'u pasur parasysh gjatë procesit të regjistrimit:

 Nëse keni lindur pas Tetorit 2000, do t'ju kërkohet të ngarkoni një formular leje e plotësuar dhe firmosur nga prindi ose kujdestari juaj si dhe një foto të letërnjoftimit të tyre bashkangjitur.

 Nëse zgjidhni të paguani me EasyPay dhe regjistroheni për here të pare, ju do të njoftoheni për hapat e aktivizimit të llogarisë brenda 24 orësh.

 Nëse zgjidhni të paguani me Visa, duhet të jeni një kartmbajtës Visa. Personat të cilët kanë një kartë tjetër (psh Mastercard) nuk mund të paguajnë në këtë mënyrë.

o Kartmbajtësit MasterCard mund të rimbushin llogarinë e tyre EasyPay me kartën e tyre dhe më pas të paguajnë për Maratonën duke përdorur llogarinë e tyre EasyPay.

o Nëse keni një kartë Visa dhe pagesa sërish nuk funksionon, sigurohuni që:

- Banka juaj të ketë aktivizuar pagesat online. Nëse kjo është pagesa juaj e pare online, kontaktoni me Bankën për ta pyetur për këtë opsion.
- Lidhja juaj e internetit të jetë e mire. Në rast shkoputje interneti, pagesa ndërpritet dhe ju duhet ta nisni sërish.

 Nëse nuk arrini të paguani dot online, mund të vizitoni pikën EasyPay më pranë jush duke kryer pagesën fizikisht. Kërkoni për vendndodhjen EasyPay më të afërt në: bit.ly/agjenteasypay